

LEDIA DUSHKU

**“T’A HEQIM SYNË NGA TURQIA”! PERCEPTIMI RRETH
TURQVE OSMANË NË LIGJËRIMIN E QEVERISË SË
PËRKOHSHME TË VLORËS**

Tash ç’udhë të qeverrimit Shqipëria, si mbretërië do të mbajë? Atë të Turqiës a po atë të shteteve Evropianë? Jemi të bindur krejt që Shqipëria do të mbajë të dytën, d.m.th. atë të shteteve evropianë: se ndryshe ay fat zi që gjeti Turqinë, ay fat do të gjejë dhe këtë shpejt a vonë

Përlindja e Shqipëniës, 27 gusht 1913¹

...Shqipëria lipset të qëndrojë shumë lark [nga Perandoria Osmane], se s’është Anadollak, as Shqiptarët janë anadollakë. Fati i fundit i tmerruar i Turqiës le të jetë një shembël e madhe për Shqipëriën e Shqipëtarët që të mos kenë përsipër jo vetëm gjyrmë e shënjë anadollake, jo vetëm herë e frymë turke, po as nishan, as gjë pe të Turqiës kalbur, gjithashtu as nomet as sistem gjyqsor të saj në duam me të vërtetë të lozim roll të mirë si komp e Shtet Evropian e si njerëz të dritës, të qytetërimit e të përparimit.

Harrin një robëni e pesëqindvjeshme, harinë gjithë mjerimet, poteret e të këqia e tyraniës turke; Sot, n’erë që u ndah nesh Turqia, n’herë që u mërgua nga kufit’ e Shqipëriës, lipset edhe Shqiptarët t’a heqin sytë nga Anadoll, t’a heqin synë nga Turqia dhe as gjë mos ti trashëgojnë dhespotismit barbar aziatik, as akoma nomet e kanunet e Turqiës, të cilat kurrë s’munt ta heqin përpara e t’a lartësojnë midis kombeve tjerë kombin Shqipëtar dhe Atdhenë Shqipërië ...

Përlindja e Shqipëniës, 3 shtator 1913²

I. Modeli i imagjinuar prej Rilindësve Shqiptarë për orientimin e shoqërisë shqiptare: Larg Lindjes drejt Perëndimit

Ligjërimi politik, kulturor dhe shoqëror i Rilindësve Shqiptarë, në tërësinë e tij, ecte në të njëjtën kahje me orientalizmin³ klasik evropian,

¹ Gjon Bud, “Propagandat e masat e Qeverriës”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 27 gusht 1913, f. 2-3.

² Kristo Filloqi, “Gjyqësia në Shqipërië”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 3 shtator 1913, f. 3.

që evidentonte një përplasje të vazhdueshme, shpeshherë dinamike, midis dy Botëve⁴. Lindja, ose ndryshe Orienti, konsiderohej si një gjendje e palëvizshme, e përcaktuar një herë e përgjithmonë dhe e mbetur pas në kohë. Me të lidheshin kuptimet e prapambetjes, rrëmujës, misterit, tiranisë, korrupsionit, luftës, anarkisë dhe mjerimit. Përballë saj qëndronte Bota tjetër: Perëndimi, që gjeografikisht kuptonte Evropën Perëndimore dhe Amerikën. Një shtet perëndimor përfytyrohej i zhvilluar, i rregullt, i paqtë e me mirëqenie dhe, rendja drejt tij konsiderohej përparim.

Në kuadër të këtij diskursi, Rilindësit i imagjinonin shqiptarët dhe Shqipërinë në një udhëtim të gjatë e të vështirë, me stacion të përcaktuar qartë: Perëndimin. Ky proces i vazhdueshëm, i përshkruar nga sociologu Enis Sulstarova si një ikje, një arratisje, perceptohej si shpëtim nga anarkia, “poteret dhe të këqiat”, që në vetvete Lindja mbartte. Perëndimi dhe Lindja artikulohej kështu si dy mendësi të kundërta, si dy sisteme politiko-shoqërore, si dy kultura apo filozofi, si dy botë të ndryshme, që formonin struktura kundërshtare binare, të cilat kishin ndikuar dhe ndikonin fatet e shqiptarëve⁵.

“Dy qytetërimi kanë ndarë botën: qytetërim’ i Perëndimit dhe qytetërim’ i Lindjes, evidentonte gazeta Shkopi, në shkrimin e titulluar “Konstitucioni në Turqi”. I pari u gatua nga krishterimi, i dyti nga myslimanizmi. Mjerisht këta qytetërimi u gatuan me zakone të veçantë: për këtë shak jan’armiq, njëri lufton tjetrin; dhe në këtë luftë të rreptë dhe të paarrësyer, qytetërim’i Perëndimit doli mundës (fitues) dhe s’ka dyshim që do të dal’i tillë kurdoherë....Nuk do të lodhem duke thënë: i

³ Në këtë artikull termi “orientalizëm” është përdorur në kuptimin që i jep atij historiani britanik, Alexander Lyon Macfie. Sipas tij “orientalizëm” do të thotë njohje apo dituri mbi vendet dhe popujt e Lindjes. Orientalizmi nënkupton ekzistencën e një subjekti apo autori jashtë Orientit, i cili e përcakton Orientin si objekt të vëzhgimit, njohjes e klasifikimit. Shih: A. L. Macfie, *Orientalism*, London, New York: Pearson Education, 2002, p. 25-30.

⁴ Në lidhje me përfytyrimin e Lindjes dhe Perëndimit nga orientalistët shih: Edward W Said, *Orientalism. Western Conceptions Of the Orient*, India: Pinguin Books, 1991; A. L. Macfie, *Orientalism*

⁵ Enis Sulstarova shprehet se “Arratisja e shqiptarëve prej “Lindjes” dhe rendja drejt “Perëndimit” ka shërbyer si një horizont përfytyrues, si një shtrat rregullues i pikëpamjeve të elitave politike dhe intelektuale për Shqipërinë moderne dhe identitetin evropian të kombit shqiptar. Si kundërtëzë e asaj që përfaqësonte “Perëndimi”, si “tjetri” apo mungesa e tij, qëndronte “Lindja”, Enis Sulstarova, *Arratisje nga Lindja. Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*, botim i tretë i ripunuar, Tiranë: West Print, 2013, f. 26.

mir i lik, vetëm qytetërim’ i Perëndimit mund të na shpëtojë kombësinë dhe Shqipërinë, dhe të na sigurojë gjendjen në kërthizë të Evropës, se vetëm ky qytetërim vate mbanë ndë botë dhe gatuan njerëzit pas nevojave të kohës, që ndryshon pa reshtur. Bota përparoi me ndihmë të këtij qytetërimi; kujtoni ç’ka qen Evropa dhe qush është sot; shihni Xhaponë (Japoninë) sa përparoi që ditën që zuri të marrë zakonet politik të Evropës dhe qytetërimnë...shukoni Turqinë ndë ç’shkallë gjendet, se deshi të bëjë udhë mi vehte ndë mes të Evropës⁶.

Si ligjërim modernizues i elitave politike dhe intelektuale shqiptare, ligjërimi i Rilindësve i ndërtoi realitetet mbështetur në dallimin Perëndim\Lindje. Në këtë qasje, ai konstituoï kundërvënien e racës evropiane shqiptare me atë aziatike turke, ngjashëm me nacionalizmat e krishterë të Ballkanit, duke huazuar klishtë evropiano-krishterocentrike mbi despotizmin dhe barbarinë turko-orientale⁷. Të paktën që prej gjysmës së dytë të shek. XIX, turqit përshkruheshin si të kundërtit e shqiptarëve, me cilësi të ulëta, që shqiptarët nuk i kishin dhe nuk donin t’i kishin. Ata ishin aziatikë, barbarë, të egër, shkatërrimtarë, fanatikë e të prapambetur, pa asgjë të përbashkët me shqiptarët, të cilët nuk vinin nga Azia, por ishin kombi më i vjetër i Evropës.

“Ç’janë Tyrqitë?-pyeste Sami Frashëri në veprën e tij Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhet? Mendime për shpëtimt të Mëmëdheut nga rreziket që e kanë rrethuarë, botuar për të parën herë në Bukuresht, më 1899, e konsideruar si manifesti i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. “Një komp i egërë t’ardhurë nga shkretëtirat’ e Asisë së Veriut me nga një hosten në dorë. Këta me egërsi të tyre zunë më të bukurit’ e vendeve të botës e më të qytetëruarët; edhe si i ropnë, i gremisë e i dogjnë, po i mbajnë edhe gjer më sot nënë një egërsi, nënë një varfëri, nënë një tirani që tëmeron gjithë botën. Nga gjithë këtë vende...njëri është Shqipëri’ e gJORë...Na ç’kemi me ta? A mos ethmë me ta? Jo kurrë! Na s’jemi as Tyrq as të ardhurë nga shkretëtirat’ e Asisë. Na jemi m’i vjetri komp i Evropesë; kemi të drejtë në dhet’ t’Evropesë më tepër se çdo komp”⁸.

Turqit artikuloleshin si përgjegjësit kryesorë për mjerimin dhe paditurinë e shqiptarëve. *“Turqitë, që janë zotërinjt’ e tyre që pesëqind*

⁶ “Konstitucioni ndë Turqi!”, në *Shkopi*, Kajro, 15 nëntor 1908.

⁷ E. Sulstarova, *Arratisje nga Lindja...*, f. 38.

⁸ Sami Frashëri, *Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhet? Mendime për shpëtimt të Mëmëdheut nga rreziket që e kanë rrethuarë* (botuar për të parën herë në Bukuresht, më 1899), Tiranë: Naim Frashëri, 1962, f. 63-64.

vjet e tëhu, shprehej Sami Frashëri, *s'u kanë mësuarë Shqiptarëvet as punë, as mjeshtëri as dituri, po i kanë mësuarë të lëftojn' e të rrëmbejnë*⁹. Të njëjtën esencë ligjërimi përdorte edhe Kristo Dako. Sipas tij, *"...vetëm një komb ka mbetir endë në erësirë e mjerim. Ky është kombi Shqipëtar, i cili është m'i vjetërë se ç'do tjetër komb i Evropës...sot e kanë sjellë të rie më një anë, i humbur me një copë vënt, lark qytetërisë!*¹⁰

Pas zhgënjimit që solli rivendosja e Kushtetutës Osmane (1908), dallimi shqiptar\turk u evidentua dukshëm në faqet e shtypit, kryesisht të atij në diasporë. Tashmë publicistika u pasurua edhe me përdorimin e epiteteve fyese për turqit osmanë, si "halldupë" dhe "anadollakë". Këto epitete u përdorën në vazhdimësi dhe përfaqësuan mendësi a shprehi të prapambetjes dhe të konservatorizmit.

Jani Vruho, në gazetën "Liri e Shqipërisë" shprehej se:

*"Ja tek po na shfaqen përditë përpara syvet halldupët, me ato sjella e me ato enstinkta të krupta, të cilat veç Anadolakëvet, as Afrikanëvet s'u kanë hije. Me gjithë se jemi racë m'e fisme e me lastë nga çdo race evropiane; me gjithë që as kurrën e kurrës s'kemi rëfyer vetia fanatike t'anadollta, të vritemi për punëra feje, Anadolakët duan e deshirojnë që me hir e me pahir të na ngjyëjë me bojëra të pista t'anadollta, të vrasëm vëllaj-vëllaj, duke na ngacmuar halldupët me anën e fesë"*¹¹.

Në të njëjtën linjë perceptimi shkonin edhe shkrimet e gazetës *Kombi*, në Boston të Amerikës. Në shkrimin e titulluar "Zumë të lëvizim", autori, i cili kishte preferuar të ishte anonim, jo vetëm evidentonte gjendjen e ulët në të cilën ndodheshin turqit osmanë, por theksonte paaftësinë e tyre për të drejtuar popuj "më të lartësuar se ata", duke nënkuptuar shqiptarët: *"Populli turk gjendet siç e di tërë bota në një shkallë të hunjtë (ulët) se gjithë kombësit' e Evropës. Asnjë prej ato që lyp sot qytetërimi nuk kanë, si pra kanë egoist kombëtare të heqën prej hunde ose të bëhen udhëheqës të kaq popujve më të lartësuar se ata?"*¹².

Ndërsa liriku A. Shkaba, me vargjet e tij, paraqiste një lloj ambiguiteti midis Turqisë së prapambetur, si brengë që mundon shqiptarët, dhe Turqisë si mike, që i kishte shpëtuar ata nga fqinjët lakmitarë. Përmes vargjeve, ai i mësonte lexuesit se:

⁹ *Po aty*, f. 44.

¹⁰ Kristo Dako, "Cilët janë Shqipëtarët", në *Tomorri*, 10 qershor 1910, f. 4.

¹¹ Jani Vruho, "Tyrqit edhe Shqipëtarët", në *Liri e Shqipërisë*, 10 maj 1911, f. 2.

¹² "Zumë të lëvizim", në *Kombi*, Boston, 11 shtator 1908.

*Shqipëria po rënkon,
Ka një brengë q’ e mundon,
E cila nuk është tjetër
Po një plagë shumë e vjetër,
Përpara ca qindra vjet
Ardh një mike dhe i mbet,
Ju plas si plëndës në derë
Dhe ju bë murris e ferrë,
Kjo mike është Turqia...¹³.*

Në antitezë me “arratisjen” nga Lindja, veçanërisht që nga fundi i shek. XIX, Rilindësit i jepnin rëndësi artikulimit të lidhjeve të kombit shqiptar me Evropën, duke kushtëzuar në këtë mënyrë gjykimin mbi lidhjet historike e kulturore të shqiptarëve me turqit brenda Perandorisë Osmane. Kjo e fundit në sytë e tyre gjithnjë e më shumë po përfaqësonte Azinë, despotizmin dhe prapambetjen. Si krijuesit kryesorë të identitetit shqiptar, Rilindësit u orvatën t’i shkëpusin bashkëkombësit e tyre nga ndikimi i Lindjes dhe t’i lidhnin me Perëndimin. Këtë ata synonin ta bënin duke përdorur së pari *provën e vjetërsisë* dhe së dyti *kontributin që shqiptarët i kishin dhënë qytetërimit evropian*.

Në ligjërimet e Naum Veqilharxhit, Pashko Vasës, vëllezërve Frashëri, Jani Vretos, Jeronim de Radës, etj., ngjizej imazhi i shqiptarëve si një komb shumë i vjetër evropian, i bashkuar përtej përkatësisë fetare¹⁴.

“Shqiptarët qofshin muslimanë, ortodoksë ose katolikë, janë edhe mbeten siç kanë qenë tridhjet shekuj më parë, populli më i vjetër i Evropës, raca më pak e përzier e gjith racave të njohura, racë e cila si një fenomen që më tepër mund të quhet mrekulli e që nuk mund t’ a shpjegojmë, ka mundur të qëndrojë kundrejt kohës që rënon e ndryshon” - shprehej Pashko Vasa, një intelektual shqiptar i konfesionit katolik, në libërthin e tij “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët”, botuar në Paris në vitin 1879¹⁵.

¹³ *Liri Shqipërisë*, 15 nëntor 1911, f. 4.

¹⁴ Në lidhje me pikëpamjet e tyre të shprehura në publicistikën e kohës shih: Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: Lindja e një kombi me shumicë myslimane*, Tiranë: Përpjekja, 2009, f. 125, 226-229, 235, 246-248, 264.

¹⁵ Vassa Effendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*, Studim historik. Përkthimi nga frëngjishtja dhe komentim prej Mehdi Frashërit, Tiranë, Shtypshkronja “Tirana”,

Prova e vjetërsisë shihej si provë e pjesëmarrjes në qytetërimin evropian. Për këtë arsye, orientimi i shqiptarëve nga moderniteti perëndimor konsiderohej si rruga e natyrshme e përparimit të tyre¹⁶. Ajo do të ishte e gjatë dhe e mundimshme dhe, si e tillë, mund të përballohej vetëm me ndihmën e Evropës. Sipas rrëfimit rilindës për historinë e kombit, shqiptarët jo vetëm që ishin rrënjë dhe farefis me Kontinentin Plakë, por ata ishin vetëflijuar për të. Për këtë, lexuesit i vinte në kujtesë figura e Skënderbeut dhe luftërat e tij kundër osmanëve.

Sami Frashëri shprehej se: “*Dyzet e kaqë vjet (40 vjet) qëndroi kështu Skënderbeu me Shqipëtarët duke var’ e duke handakosurë armikët;.... Gjithë pushtetat’ e Evropësë, q’ishinë atëherë, kishinë shpresë ne Skënderbeu e prisnin shpëtimn’ e Evropësë nga Shqipëtarët...*”¹⁷.

Ndërsa i vëllai Naimi, figurë qendrore e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, në poemën *Istori’ e Skënderbeut*, tërhiqte vëmendjen duke thënë se Evropa e shek. XV ishte a paaftë për të mbrojtur veten dhe, shpëtimi prej turqve ndodhi vetëm falë luftës së shqiptarëve me në krye Skënderbeun. Në vargjet 265-268, të këngës XIV të poemës, Naimi i tregonte lexuesit se:

*Po të mos ishte Shqipërija
Gjith’ Evropën e verbuar
E kish marrë Tyrqija
Nuk i kishte shpëtuar*¹⁸

II. Në zbatim të modelit: Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe fillesat e procesit të deosmanizimit në Shqipëri

Nëse orientimi perëndimor i Rilindjes Kombëtare kishte shprehur dëshirën e elitave politike e intelektuale që kombi shqiptar të hynte në rrugën e përparimit evropian, Shpallja e Pavarësisë dhe ekzistenca e shtetit u ofroi atyre shansin për të zbatuar eksperimentin e modernizimit të Shqipërisë. Kjo do të shmangte edhe etiketimin që mund t’i bëhej shtetit shqiptar, si një “shtet mysliman”, që nuk e kishte vendin në Evropë, por i përkiste Lindjes.

1935, f. 61; Dritan Egro, “Perceptimi i Perandorisë Osmane dhe Evropës në doktrinën nacionaliste shqiptare”, në *Studime historike*, 3-4, Tiranë: 2013, f. 51-61.

¹⁶ E. Sulstarova, *Arratisje nga Lindja. Orientalizmi shqiptar...*, f. 51.

¹⁷ S. Frashëri, *Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhet?*..., f. 25.

¹⁸ E. Sulstarova, *Arratisje nga Lindja. Orientalizmi shqiptar...*, f. 70.

Tash ç’udhë të qeverrimit Shqipëria, si mbretërië do të mbajë? Atë të Turqisë a po atë të shteteve Evropianë? Jemi të bindur krejt që Shqipëria do të mbajë të dytën, d.m.th. atë të shteteve evropianë.

Kjo ishte pyetja që i bëhej lexuesit të gazetës *Përlindja e Shqipëniës*, organi zyrtar i qeverisë së përkohshme të Vlorës dhe përgjigjja që i jepej për drejtimin e Shqipërisë pas Shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912. Shkëputja nga Perandoria Osmane dhe krijimi i shtetit të pavarur shqiptar i vendosi institucionet dhe organizimin e tyre në një realitet të ri politik, juridik dhe administrativ, të ndryshëm nga ai ku ato kishin vepruar deri në atë moment. Ndonëse me legjitimitet të përkohshëm, qeveria e Ismail Qemal Vlorës e përqendroi vëmendjen në çështje thelbësore të qeverisjes, ku dallohej sendërtimi i sistemeve shekullare\jo fetare të centralizuara, tipar ky i qeverisjeve perëndimore¹⁹. Kjo përpjekje mund të konsiderohet si embrioni e një procesi të gjatë shtetformimi dhe deosmanizimi nëpër të cilin do të kalonin shqiptarët dhe shteti i tyre. Përfundimi me sukses i tij nuk do të ishte gjë tjetër veçse zbatimi në terren i modelit të imagjinuar prej rilindësve shqiptare për orientimin e shtetit dhe të shoqërisë shqiptare: Larg Lindjes pranë Perëndimit.

Sendërtimi i sistemeve shekullare të centralizuara vlerësohej si një nismë e rëndësishme për Shqipërinë e asaj kohe, që synonte shfuqizimin e heterogjenitetit dhe forcës së autoritetit fetar, si pushtet udhëheqës,

¹⁹ Sipas profesorit amerikan Berndard Lewis, fjala “shekullarizim” në kuptimin e saj të parë tregon një doktrinë sipas së cilës morali duhej të mbështetej në parime racionale, që kishin të bënin me mirëqenien e njeriut në këtë botë, duke përjashtuar kështu çdo lloj konsiderate që lidhej me Zotin, apo me jetën e përtejme. Më pas ajo mori një kuptim më të përgjithshëm, për të shprehur idenë se institucionet publike, sidomos arsimit i përgjithshëm, duhet të ishin shekullarë dhe jo fetarë....Në domethënien moderne politike që ka marrë fjala “shekullarizëm”, pra ideja sipas së cilës pushteti fetar e ai politik, kisha dhe shteti janë dy gjëra të ndryshme, që mund dhe duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra, është një nocion thellësisht i krishterë. Zanafilla e kësaj duhet kërkuar në mësimet e Krishtit, të cilat përvoja e të krishterëve të parë vetëm sa i përforcoi; ky koncept evoluoi më tej, duke u kushtëzuar, në një farë mënyre, nga vetë historia e mëpasme e Krishterimit. Persekutimet që iu bënë Kishës në fillimet e saj e bënë të qartë se një ndarje mes dy institucioneve ishte diçka e mundshme. Persekutimet që vetë Kisha bëri më pas, shërbyen për të bindur shumë nga të krishterët se një ndarje e tillë përbënte një domosdoshmëri. Bernard Lewis, *Ku është gabuar? Islami, Perëndimi dhe moderniteti* (përktheu nga anglishtja Piro Misha), Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2004, f. 155-159.

organizues dhe fragmentar brenda shtetit të ri. Shqiptarët duhej ta perceptonin shtetin e tyre si laik dhe, si i tillë ai nuk do të mund t'i përkiste ndonjë feje të veçantë, por të gjithëve, çka do t'i hapte rrugë krijimit dhe vendosjes së autoritetit të shtetit mbi të gjithë shoqërinë. Në sajë të këtij procesi do të homogjenizohej marrëdhënia e shoqërisë me qeverisjen dhe do të universalizohej procesi i shtetformimit, me anë të një administrate kombëtare, një sistemi arsimor unik dhe një gjuhë, jo vetëm semantike, por edhe praktike. Në këtë mënyrë, ndërgjegjja e shqiptarëve si edhe institucionet e ndryshme sociale e fetare, do të formonin një kohezion me sistemin politik, përtej kufijve që Shqipërinë e mbanin ende të copëzuar së brendshmi²⁰.

Së pari, laicizmi u projektua në sistemin e drejtësisë. Më 5 maj 1913 qeveria e përkohshme miratoi Kanunin e Jurisë, i cili ishte një ndërthurje e parimeve evropiane të së drejtës me Sheriatin Osman. U vendos bashkimi i çështjeve civile me ato penale, gjykimi i tyre jo më nga kadijtë por nga gjykatat shtetërore. Për çështjet penale u krijua sistemi i jurisë. Gjyqet e Sherisë, me në krye myftiun, do të trajtonin vetëm çështjet me karakter fetar. Trajtimi i problemeve penale dhe civile nga gjykatat e reja, praktikisht, çonte drejt shkrirjes së gjykatave fetare, të trashëguara nga sistemi osman. Qeveria e përkohshme e Vlorës emëroi kryemyftiun, si kreu më i lartë i komunitetit mysliman në Shqipëri dhe kadiun e përgjithshëm. Të dy emërimet u bënë pa marrë pëlqimin e Stambollit, duke thyer kështu nënshkrimin ndaj Sheh-ul-Islamit osman. Njëkohësisht ky ishte hapi i parë dhe më i madhi për shkëputjen e xhamive në Shqipëri nga Kalifati. Qeveria sanksionoi funksionin e postit të myftiut, duke caktuar vendosjen e tyre territoriale, pagën dhe gjuhën që do të përdorej për vendimet e çështjeve fetare. Nga pikëpamja fetare pozicioni i tij miratohej vetëm nga kryemyftiu²¹.

Procesi i laicizimit trokiti edhe në administratën e re shtetërore. Që prej 30 gushtit të 1913-ës zotërimi i shqipes u vendos nga qeveria e përkohshme, si kusht themelor për të gjithë nëpunësit ekzistues dhe ata rishtarë që dëshironin të punonin në institucionet shtetërore. Sakaq nisi puna për riorganizimin administrativ dhe emërimin e nëpunësve të rinj,

²⁰ Sokol Gjermëni, "Aspekte të jetës komunitare në Shqipëri përgjatë vitit 1913", *Studime Historike*, 3-4, Tiranë: 2013, f. 86.

²¹ *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28 nëntor 1912-22 janar 1914)*, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të R.P.SH, Tiranë: Mihal Duri, 1963, f. 130, Vendim i qeverisë së Përkohshme të Vlorës, dt 5 maj 1913.

ndërkohë që qeveria u bëri thirrje intelektualëve brenda dhe jashtë Shqipërisë ta vinin dijen e tyre në shërbim të shtetit.

Veprimtaria e administratës shtetërore u vendos mbi baza ligjore, më 22 nëntor 1913, me shpalljen e “Kanunit të Përtashëm të Administratës Civile”. Ky ligj u hartua mbi bazën e parimit të pushtetit të njësuar, duke lënë mënjanë idenë e kantonizimit, ndonëse ajo mbështetej nga kryetari i qeverisë së përkohshme, Ismail Qemal Vlora. Me të drejtë, disa ministra dhe një pjesë e opinionit publik e gjykuan kantonizimin si të papërshtatshëm, në kushtet kur Shqipëria, më shumë se kurrë, kishte nevojë për unitet administrativ. Kanuni i Përtashëm nuk kishte karakterin e ligjit themeltar e, si i tillë trajtonte vetëm çështjet e administratës vendore, njësitë e kompetencat e tyre. Në të ishin specifikuar disa nene edhe për komunitetet fetare, çka i shërbente qëllimit për të vendosur lidhjet më të afërta dhe për të organizuar më mirë funksionimin e komuniteteve fetare në raportet me institucionet civile dhe administrative të shtetit. Në këtë mënyrë, qeveria institucionalizonte funksionimin, kompetencat, detyrat dhe organizimin e komuniteteve fetare në bazë të legjislacionit shtetëror shqiptar. Ndarja e shtetit nga feja dhe përpjekjet për institucionalizimin e legjitimitetit të qeverisjes krijonin premisa për zhvillimin e mëtejshëm të komponentëve laikë, duke i bërë ato pjesë të organizimit dhe funksionimit institucional, kulturor, politik dhe publik brenda shoqërisë shqiptare²². Pavarësisht hartimit të “Kanunit të Përtashëm të Administratës Civile”, qeveria e përkohshme e Vlorës ishte ende larg hartimit dhe zbatimit të një legjislacioni të plotë laik, që do të zëvendësonte legjislacionin osman.

Qeveria e përkohshme shqiptare kërkoi ta shtrinte laicizmin edhe në fushën e arsimit, duke synuar krijimin e një sistemi arsimor kombëtar, jo fetar. Ministri i Arsimit, Luigj Gurakuqi u angazhua seriozisht në këtë proces. Në zbatim të kësaj politike, në gusht të vitit 1913, u vendos “*që të çilet në çdo sundimtari nga një normale përgatitore ku nxënësit do të pranoheshin mbi bazën e disa kushteve*”²³. Kushtet caktoheshin në urdhrin e Ministrisë së Arsimit, të datës 31 gusht 1913, sipas të cilit, shkolla fillore ishte e detyrueshme për të gjithë nxënësit e Shqipërisë, kurse shkollat e veçanta do të funksiononin vetëm pasi të kishin plotësuar kriteret e

²² S. Gjermëni, “Aspekte të jetës komunitare në Shqipëri...”, f. 86.

²³ “Urdhër i Ministrisë së Arsimit” në *Përlindja e Shqipënisë*, Vlonë, 24/6 gusht 1913.

përcaktuara në ligj²⁴. I gjithë sistemi arsimor duhej t'i nënshtrohej ligjeve të shtetit shqiptar. Shkollat duhej të merrnin leje zyrtare nga qeveria, të përdornin gjuhën shqipe si gjuhë mësimi, të kishin programe dhe libra të njohura nga Ministria e Arsimit. U vendos që mësimi, duke përfshirë edhe shkollat e komuniteteve fetare e të huaja, të bëhej në gjuhën shqipe. Për përgatitjen e mësuesve u rihap Normalja e Elbasanit me drejtor, mësuesin e përkushtuar Aleksandër Xhuvani. Një tjetër shkollë normale nisi të funksionojë në Berat. Njëpërmjet drejtorive arsimore në prefektura, u organizuan kurse për nëpunësit që të njihnin më mirë gjuhën shqipe, me shkrim dhe lexim. Nga ana tjetër, qeveria e përkohshme iu përgjigj pozitivisht kërkesës së qeverisë italiane dhe austro-hungareze për studimin e të rinjve shqiptarë me bursa jashtë Shqipërisë²⁵.

Ministria e Arsimit i kushtoi rëndësi edhe përgatitjes së terminologjisë shqipe për degët e administratës, të arsimit dhe të sferave të tjera të jetës së vendit. Për këtë u ngrit një komision, i cili në qershor 1913 përgatiti fjalët dhe termat e nevojshme në fushën e ushtrisë dhe të drejtësisë. Në nëntor 1913, qeveria parashikoi ngritjen e një qendre shkencore për studimin e çështjeve të gjuhës amtare, të programeve dhe të teksteve shkollore. Në thelb ky ishte projekti për themelin e një Akademie Kombëtare për çështjen e gjuhës dhe të programeve shkollore.

III. Perceptimi për turqit osmanë në ligjërimin e jashtëm dhe të brendshëm të qeverisë së Ismail Qemal Vlorës

Në ligjërimin e jashtëm dhe të brendshëm²⁶ të qeverisë së përkohshme të Vlorës, perceptimi për turqit osmanë nuk shfaqej unik. Ai ishte fluid, duke marrë tone të ndryshme në varësi të qëndrimit që Fuqitë e Mëdha mbanin ndaj çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve

²⁴ “Urdhër i Ministrisë së Arsimit” në *Përlindja e Shqipërisë*, Vlonë, 31/13 shtator 1913.

²⁵ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej *HHSt.A.P.A.A*) në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*) Vj. 23-20-2057, Qarkore e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për bursat e të rinjve shqiptarë, nëntor 1913.

²⁶ Termi “ligjërim i jashtëm” në këtë artikull përdoret në kuptimin e ligjërimin që qeveria e përkohshme shqiptare dhe kryetari i saj Ismail Qemal Vlora përdor jashtë shtetit, në raport me Fuqitë e Mëdha dhe Perandorinë Osmane. Ndërsa “ligjërim i brendshëm” ka parasysh diskursin e përdorur nga qeveria e përkohshme e Vlorës brenda shtetit, midis vetë shqiptarëve.

në Londër. Fluide shfaqej edhe pesha që ligjërimi i brendshëm dhe ai i jashtëm zinte në esencën e përgjithshme ligjëruese të qeverisë shqiptare. Prej dhjetorit 1912 deri në maj 1913, kur Fuqitë e Mëdha në Londër i qëndruan vendimit për autonominë e Shqipërisë nën suzerenitetin e Sulltanit, vëmendjen kryesore e mori ligjërimi i jashtëm. Qëllimi final i qeverisë së Vlorës ishte bindja e Të Mëdhenjve se shqiptarët e meritonin shtetin e tyre të pavarur. Në maj, Fuqitë e Mëdha ndryshuan qëndrim, duke rënë dakord të ndërprinin çdo lidhje të Perandorisë Osmane me shtetin shqiptar dhe të merrnin vetë në dorë të ardhmen e tij. Vendimin përfundimtar ata e shprehën më 29 korrik 1913. Sipas tij, Fuqitë e Mëdha njohën shtetin e pavarur shqiptar, me një princ të huaj në krye dhe ruajtën ndikimin e tyre në Shqipëri nëpërmjet krijimit të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Gjatë kësaj periudhe (maj-korrik 1913) në ligjërimin e qeverisë së përkohshme shqiptare vihet re një baraspeshë në raportin midis ligjërimin të jashtëm dhe atij të brendshëm. Duke filluar nga gushti i 1913-s peshën kryesore e mori ligjërimi i brendshëm.

Tipare të ligjërimin të jashtëm

Në ligjërimin e jashtëm të qeverisë së përkohshme shqiptare, perceptimi për turqit osmanë ruante ngjyra diplomatike dhe institucionale, karakteristike kjo dalluese edhe në të folurën e mëhershme të kryetarit të saj, Ismail Qemal Vlorës²⁷. Si pjesë e elitës politike e diplomatike osmane, me lidhje të vazhdueshme dhe intensive me shtetarë

²⁷ Ismail Qemal Vlorë personifikonte shtetarin me mendime përparimtare e liberale, me aftësi të rralla diplomatike, të cilin regjimi osman ishte munduar ta bënte të padëmshëm, jo vetëm duke e mbajtur larg vendlindjes, por edhe duke i ofruar funksione të larta në piramidën shtetërore osmane, të cilat i shkonin përshtat përgatitjes së tij. Nga nëpunës në Zyrën Juridike të Këshillit të Shtetit apo sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme Osmane, Qemali u emërua kryetar i Bashkisë së Janinës, për të vazhduar në vitet në vijim si guvernator i vilajetit të Bejrutit e atij të Tripolit. I cilësuar si antiosman, por jo antiperandori, Ismail Qemali në vazhdimësi kishte kundërshtuar politikën centralizuese të Portës, duke acaruar herë pas here marrëdhëniet me të. Partizan i reformave në jetën shtetërore turke, që kishte mbështetur hapur reformatorin radikal Mid’hat Pashën, atin e Kushtetutës Osmane të vitit 1876. Me të, I. Qemali ndante edhe simpatinë për Britaninë e Madhe dhe Francën. Pas Revolucionit të Turqve të Rinj dhe rivendosjes së Kushtetutës, në korrik 1908, drejtoi Partinë Liberale Osmane (AHRAR). Për më shumë shih: Ledia Dushku, *Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia (1912-1914)*, Tiranë: Kristalina-KH, 2012, f. 59-65.

perëndimorë, esenca ligjëruese në publicistikën e I. Qemalit shfaqte tone të moderuara, përgjithësisht të ftohta dhe asnjane. Ndonëse përballja mes Lindjes dhe Perëndimit ishte e pranishme, ajo artikulohej pa ngjyresa fetare dhe pa prezencën e notave të ashpra. Në intervistën dhënë gazetës “Mokattan” të Egjiptit, më 13 mars 1901, pinjulli i Vlorajve evidentonte se:

“...në Lindje ka një pengesë për përparimin e myslimanëve dhe shkaktarë janë ata vetë. Ata nuk duan të përfitojnë nga mësimet e fqinjëve të tyre, ata e mbajnë veten më të ditur nga të gjithë popujt e tjerë, të gjithë ata që nuk janë të besimit të tyre i quajnë më të ulët dhe nuk kanë aspak dëshirë të kenë marrëdhënie me ta.

Qytetërimi i madh i sotëm u përket evropianëve, të cilët janë në përgjithësi të krishterë. Si rrjedhim, bashkëfetarët e mi mendojnë se ky qytetërim është i krishterë, ndërsa në realitet ai është vetëm shoqëror. Në këtë mënyrë ata nuk i dorëzohen këtij qytetërimi dhe qëndrojnë larg atyre që janë iniciatorë të tij...²⁸.

Në ligjërimin e Ismail Qemal Vlorës, reformimi institucional, politik dhe shoqëror i Perandorisë Osmane konsiderohej i domosdoshëm dhe i nevojshëm për jetëgjatësinë e saj dhe ruajtjen e statusquosë në Ballkan. Por ky proces duhej bërë në bashkëpunim me Fuqitë e Mëdha, pasi vetëm ndërhyrja e tyre do ta detyronte Sulltanin të kryente reforma në institucionet qeverisëse osmane²⁹. Në intervistën dhënë gazetës italiane *La Tribuna*, më 27 korrik 1907, Ismail Qemali guximshëm shprehej se “*Turqia është një pjesë e Evropës, ndonëse duhet të dallojmë në të një masë orientale që nuk mund të jetë e asimiluar tërësisht në Evropën e vërtetë*”³⁰.

Sa i përket Shqipërisë, orientimi nga Perëndimi nuk artikulohej hapur në ligjërimin e tij, por nënkuptohej me ëndrrën e saj, rendjen drejt “idealit të lirisë dhe të pavarësisë”. Sikurse për Perandorinë Osmane, edhe përparimi i saj duhej bërë me mbështetjen e Evropës. Me një gjuhë të sigurtë, në intervistën dhënë të përditshmes italiane *La tribuna*, Ismail

²⁸ *Ismail Qemali (Përmbledhje dokumentesh) 1888-1919*, përgatitur nga Teuta Hoxha, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 68. Intervistë e Ismail Qemalit për gazetën Mokattan të Egjiptit, 13 mars 1901.

²⁹ Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, (përktheu Dritan Egro), Tiranë: Dituria dhe Shtëpia e Librit&Komunikimit, 2002, f. 236.

³⁰ “La politika nei Balkani”, Intervistë me Ismail Qemal Vlorën në gazetën *La Tribuna*, 27 korrik 1907.

Qemali informonte opinionin publik se: *“Shqipëria gëzon një gjuhë të vetën, një letërsi, një histori dhe tradita të veta, ka të drejtën e saj të kërkojë një afirmim kombëtar duke ndjekur idealet e lirisë dhe të pavarësisë. Ëndrra e saj meriton mbështetjen e qytetërimit civil, të latinëve në përgjithësi dhe të italianëve në veçanti”*. Prova e vjetërsisë së shqiptarëve³¹ risillej në vëmendjen e lexuesit. *“Ne shqiptarët”*, shprehej pinjoll i Vlorajve, *“jemi kombi më i vjetri, më i nderçmi i gjithë Evropit. Pa ardhur grekrit, pa qenë romanët, pa lindur bizantinët, neve ishim!”*.

Perceptimi për turqit osmanë në ligjërimin e Ismail Qemalit, përgjithësisht i përgjigjet formatit të një diplomati të kujdesshëm dhe me përvojë, pa përdorur epitete fyese, si barbarë, të egër, apo të pacivilizuar. Vetëm në një rast kemi mundur të gjejmë një prononcim negativ, i pasqyruar në gazetën *Shkupi*, të datës 2 qershor 1912. Aty turku konsiderohej “barbar”, një racë që nuk “mer përparim e qytetni”. Ndonëse editorit i gazetës shfaqte dyshime për vërtetësinë e lajmit, është e rëndësishme të mos e shkëpusim atë nga shtrati historik. Në atë kohë Ismail Qemal Vlora përpiquej për organizimin e një kryengritjeje mbarëballkanike, prej së cilës pritej të arrihej rrëzimi i qeverisë xhonturke dhe ardhja në pushtet e një qeverie liberale osmane. Në këtë kuadër, ai u bënte thirrje shqiptarëve, grekëve dhe bullgarëve:

*Bashkohuni ju Shqiptar, e ju Grek e ju Bullgar, t’perzam ksatt (sot) ket tyrk barbar! Masnaj shton dhe kto: Rasa Tyrkut so ras qe mer përparim e qytetni*³².

Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në ligjërimin e jashtëm të Ismail Qemal Vlorës dhe qeverisë që ai drejtonte nuk anashkalohej gjuha diplomatike dhe ajo institucionale. Kujdesi për të mbajtur një qëndrim të ekuilibruar me Perandorinë Osmane ishte tipar dallues i tij. Në memorandumin e qeverisë së përkohshme të Vlorës dërguar Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 2 janar 1913, fakti se Shqipëria *“nuk ka qenë në gjendje të ndjekë kombet perëndimore në zhvillimin e tyre të mrekulluarshëm në rrugën e përparimit dhe të qytetërimit”*, paraqitej qartë që në faqen e parë të tij, por shkaqet e kësaj prapambetjeje nuk

³¹ Prova e vjetërsisë është pjesë e ligjëritit të Ismail Qemal Vlorës edhe në dy thirrjet drejtuar shqiptarëve, në vitin 1900 dhe 1909. *“...t’i shigurojmë vetes ndihmën e kombeve e t’Europës, të cilëve kemi arsye të thohemi vëllezër, aqë më tepër, sa ne jemi kombi më i vjetër i Evropës”*, shprehej ai në thirrjen drejtuar shqiptarëve në vitin 1900. *Ismail Qemali (Përmbledhje dokumentesh) ...*, f. 61.

³² “Ismail Qemali tha kto fjal” në *Shkupi*, 2 june 1912.

artikuloleshin haptazi. Ato rumbullakoseshin me shprehje të tilla si: “kushtet jo të përshtatshme që e kanë rrethuar” apo “ka vuajtur shumë nën zgjedhën e të huajve”, pa i akuzuar turqit osmanë si shkaktarë të prapambetjes. Duke dashur të evitohej acarimin me to, në kushtet kur Fuqitë e Mëdha kishin vendosur që Shqipëria të ishte autonome, në memorandum ishte shmangur me kujdes përdorimi i figurës së Skënderbeut dhe i luftërave të tij, por pa anashkaluar përkufizimin e identitetit kombëtar shqiptar si i kundërt me Lindjen dhe trajtimin e shqiptarëve si të ndryshëm nga turqit, pavarësisht se në shumicë ata ishin myslimanë. Në huazim nga Rilindësit, në vëmendjen e ndërkombëtarëve, risillej prova e vjetërsisë. Shqiptarët ishin kombi më i vjetër i Evropës, që manifestonte pikëpamje liberale dhe nuk e kishte “*humbur meritën para kombeve perëndimore, përparimet e të cilëve ai dëshiron t’i arrijë nën një tokë që kërkon vetëm të lulëzojë*”³³.

Ndonëse me tone disi të zbehta, pjesë e ligjërimit të jashtëm të qeverisë së përkohshme të Vlorës ishin edhe shekullarizimi i shtetit, pluralizmi fetar, barazia e komuniteteve fetare para ligjit dhe shtetit, tipare kryesore këto, që do t’i jepnin një fytyrë evropiane shtetit të porsalindur, duke e afruar atë me qytetërimin perëndimor dhe larguar nga Lindja. Në intervistën dhënë gazetës franceze *Le Matin* në prill 1913, Ismail Qemali i bënte me dije opinionit ndërkombëtar se në Shqipëri: “...do flitet një gjuhë, do kemi një palë të drejta për të gjithë. Nuk do të ketë asnjë ndryshim midis katolikes, myslimanës dhe ortodokses, të gjithë do të jenë baras. Nuk do të ketë në ne ngateresa feje”³⁴.

Tipare të ligjërimit të brendshëm

Në raportet brenda shtetit, ligjërimi i qeverisë së përkohshme të Vlorës mori përsipër misionin qytetërues ndaj shoqërisë, pakicave apo kategorive të caktuara periferike (fshatarë, malësorë, etj), perceptimi dhe mënyra e jetesës së të cilave nuk i përshtatej vizionit që elita, në këtë rast qeveria, kishte mbi shtetin dhe shoqërinë. Bëhet fjalë për atë që studiuesi i qytetërimeve Ferdinand Braudel e konsideron si *punë e vetes mbi*

³³ *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (nëntor 1912 - janar 1914)*, përgatitur për botim nga Arkivi Qendror i Shtetit, Tiranë: 8 Nëntori, 1963, f. 98-100. Memorandumi i delegatëve të qeverisë së përkohshme të Vlorës dërguar Konferencës së Ambasadorëve dhe Fuqive të Mëdha në Londër, 2 janar 1913.

³⁴ “Ç’thotë Ismail Qemali”, në *Liri e Shqipërisë*, Sofje, 22 prill 1913, f. 2.

*veten*³⁵. Përmes publicistikës, në faqet gazetës *Përlindja e Shqipëniës*, intelektualët shqiptarë morën përsipër rolin e emancipuesit të shoqërisë dhe të kombit gjatë procesit të shtetformimit dhe modernizimit. Ato u bënë kështu ndërgjegjja e kombit, zëri i moralit publik dhe vizionarët e zhvillimit kulturor e shoqëror të shqiptarëve.

Edhe pse një pjesë e mirë e intelektualëve shqiptarë të kohës ishin pjesë e kontekstit osman të reformimit të shtetit, ata u përpoqën të ndaheshin nga e kaluara, duke i diferencuar sa më shumë shqiptarët nga turqit, pavarësisht se në shumicë ata i përkisnin të njëjtës fe, asaj myslimane. Argumentimi, që përdorej në këtë rast ishte i njëjtë me atë që kishin përdorur më herët rilindësit shqiptarë. Ai lidhej me qenien e turqve një popull aziatik, për të cilin, konsideroheshin të huaja përparimi, dituria dhe qytetërimi. Në antitezë me ta, kombi shqiptar ishte evropian në rrënjë dhe në thelb të tij. Si i tillë, ai mund të përparonte me shpejtësi “*si të gjithë kombet e qytetëruara dhe të liruara midis shteteve të Evropës*”, veçanërisht tashmë me shpëputjen nga Perandoria Osmane. Në dallim nga ligjërimi i jashtëm, gjuha e përdorur ishte e drejtpërdrejtë dhe pa doreza diplomatike. Sundimi i gjatë osman cilësohej hapur si shkak kryesor i prapambetje së shqiptarëve dhe i largësisë së tyre nga qytetërimi evropian³⁶. Në shkrimin e datës 16 gusht 1913 në *Përlindja e Shqipëniës*,

³⁵ Ferdinand Braudel, *Gramatikë e qytetërimeve* (përktheu Fatos Kongoli), Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2005, f. 66.

³⁶ Sundimi i gjatë osman, në vazhdimësi, do të konsiderohet si një nga arsyet e prapambetjes së shoqërisë shqiptare, në ligjërimin e elitës politike. 12 vjet pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Mid’hat Frashëri (Lumo Skëndo), në broshurën e tij *Plagët tona. Çë nga mungon? Çë duhet të kemi?*, përpiquej të evidentonte plagët e shoqërisë shqiptare dhe njëkohësisht të zbulonte ilaçin që do t’i shëronte ato. Qartazi, në pjesën e dytë të studimit, të titulluar *Të metat tona. Të veprojmë*, ai e përcaktonte sundimin e gjatë osman si një nga arsyet e prapambetjes së shqiptarëve. Përmes figuracionit letrar, ai sundim i paraqitej lexuesit, si një hije e zezë, si një gur i rëndë që kishte rënduar mbi mendjen dhe vetëdijen e shqiptarëve, si një kohë e errët “që ment na shoj çdo ndjenjë njerëzие, çdo cilësi njeriu të ndershme”.

“Sundimi pesë shekullor i Tyrqisë, një sundim nga më të zezët që kanë njohurë historit e botës, analizonte Mid’hat Frashëri, na ka shtuar të metat e vjetra, duke na pakësuar virtytet: Tyrku na mësoj edhe një herë akoma ma përtacë, më të harbuarë; na mësoj që të mos e duamë ligjin, të mos e njohim, të mos i bindemi. Na stërviti edhe një herë më tepër që të rrojmë dhe jo me diersën e ballit tënë....Edukata që muarmë në oxhakët e Jeniçerëve na bëri të jemi të këqinj dhe të pa drejtë kundër vallezërve tanë më të dobët, të humbasim çdo ndjenjë dhe virtyt kombi, të gjendemi si fis i egrë, armik dhe i përçarë me njëri-tjatrin, pa asnjë farë bashkimi, indiferent në përparim, të mërguarë prej çdo lumtërije materiale, me qënë se të larguarë nga

ai perceptohej si “një cergë e zezë, e cila qëndronte mbi Shqipëriën dhe si njeh reë e madhe e mbulonte më gjithë anët duke ndaluar shtizat e ndriçme të Diellit që të ngrohë zëmrën e të ndriçojë mëndjen e Shqiptarit me dritën e qytetërimit e të arsimit”³⁷. Perandoria Osmane ishte e keqja, barbarja, aziatikja, tiranikja që i kishte mbajtur shqiptarët në padije, në varfëri, mjerim e prapambetje, “...pa ruga, pa ndërtesa, pa as ndonjë qytet si lypset. Na la Turqisja si na ka bërë vetë Perëndija. S’ka ndrequr as gjë si na mori kështu na la mos themi se ma keq na ka”³⁸.

Dallimi midis dy Botëve, Lindjes dhe Perëndimit shfaqej qartë në faqet e gazetës. Në shkrimin e publicistit Dionis Karbonara, në mënyrë figurative, ato paraqiteshin si dy mbretëresha, dukshëm me tipare dhe cilësi të ndryshme. E para që personifikonte Perëndimin, “...me sytë ngjyrë deti të zbeta, qe ecte nga dale dhe kishte, në këmbët e saj të bardha, sandale prej mushku e prej vjollcash, e veshurë me një rrobë të qendisurë me yjëza dhe mbi krye një kurorë të ërgjentë quhesh Shpresë”, ndërsa tjetra, pra Lindja “...me sytë të zinj porsi nata, gjithnjë të lagurë prej lotëve dhe kraharorin e fryrë nga pserëtimet, ishte veshurë parregullsisht me një rrobë të zjarrtë”³⁹.

Pjesë e ligjërimit të brendshëm në faqet e *Përlindjes së Shqipëniës* paraqitej edhe kundërshtimi që shqiptarët ndër shekuj i kishin bërë sundimit osman. Në dallim nga ligjërimi i jashtëm, nuk hezitohet të përdoret figura e Skënderbeut, luftërat e të cilit mbartnin një karakter të dyfishtë: atë të rezistencës së shqiptarëve dhe të mbrojtjes së Evropës nga turqit “barabarë”. Me doza të forta nacionaliste ai cilësohej “burri i dheut”, “trimi i madh”, “mbreti” që lëshoi “shtizat e ziarrta, shtizat e flakta e të arta mbi Shqipëniën, shtizat e liriës, të qytetërimit e të arësimit Evropian”⁴⁰, “i pa-vdekuri trimi kombëtar Gjergj Kastrioti, që për shumë kohë, pengoj të vajturit përpara të Asianëve pushtues që erthnë të

bashkimi, pa kolaborim dhe pa solidaritet...” Lumo Skëndo, *Plagët tona. Çë na mungon? Çë duhet të kemi*, Tiranë: Mbrothësia, 1924, f. 13-15.

³⁷ Beri, “Kufiët e Shqipëriës. Shqipëria e lirë”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 16 gusht 1913, f. 2.

³⁸ Grigor Cilka, “Gjindja e Shqipëniës”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 11 Kallënduar 1914, f. 2.

³⁹ Dionis Karbonara, “Të dy Mbretëshat” në *Përlindja e Shqipëniës*, 6 gusht 1913, f. 3.

⁴⁰ Beri, “Kufiët e Shqipëriës. ...”, f. 2.

shuajnë dritat qytetënoe të Evropës, duke sjellë herësirën barabare të Asisë”⁴¹.

Figura e Skënderbeut tashmë revokohej pa drojë edhe në ligjërimin e kryetarit të qeverisë së përkohshme, Ismail Qemal Vlora. Në fjalimin e mbajtur, më 28 nëntor 1912, ai u drejtohej shqiptarëve të ekzaltuar me këto fjalë:

“Porsi ëndër më duket ky ndryshim i madh i vendit t’ onë që hoqi e voi të zezat e ullirit 500 vjet me radhë ndënë sundimin turk, por që tani në kohën e fundit, ishte gati të jepte shpirtin përgjithënjë, të shuhej e të çfarrosej krejtësisht nga faqja e dheut, kjo Shqipëri që dikur shkëlqente nga trimëria e pashoqe e bijve të saj; kjo Shqipëri që kur i kërcënohe rreziku Europës nga pushtimet e Turqisë, ndënë kryetrimin e pavdekur të saj, Skënderbejnë, u bë porta e hekurtë kundra sulmeve më të tërbuara të sulltanëve më t’ egër që ka pasë Turqia”⁴².

Një tjetër tipar i ligjërimin të brendshëm ishte evidentimi qartazi i dallimit shqiptar\turk dhe perceptimi i Shqipërisë si e kundërta e Turqisë, pa asgjë të përbashkët me të. *“Shqipëria nuk është Anadoll, as shqiptarët anadollakë*”⁴³, ndërkohë që *“mira e Turqiës mund të jetë e liga e Shqipniës*”⁴⁴. Për të shmangur fundin e keq, shqiptarët duhej *“t’ i hiqnin sytë nga Anadoll, nga Turqia*”, të shkëputeshin plotësisht nga e kaluara osmane, të shikonin drejt së ardhmes dhe të përqafoni qytetërimin evropian, *“rrojtja pas të cilit asht shpëtimi i përparim të kombit*”⁴⁵.

Fati i fundit i tmerruar i Turqiës le të jetë një shembël e madhe për Shqipëriën e Shqipëtarët që të mos kenë përsipër jo vetëm gjurmë e shënjë anadollake, jo vetëm herë e frymë turke, po as nishan, as gjë pe të Turqiës kalbur ... në duam me të vërtetë të lozim roll të mirë si komp e Shtet Evropian e si njerëz të dritës, të qytetërimin e të përparimit. Sot lipset edhe Shqiptarët t’ a heqin sytë nga Andolli, t’ a heqin synë nga Turqia dhe as gjë mos ti trashëgojnë dhespotismit barbar aziatik, as akoma nomët e kanunet e Turqiës, e cila kurrë s’ munt ta heqin përpara e t’ a lartësojnë midis kombeve tjerë kombin Shqipëtar dhe Atdhenë

⁴¹ Kostë Çekrezi, “Shpresë, punë, Bashkim!”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 20 gusht 1913, f. 1-2.

⁴² Ismail Qemali (*Përmbledhje dokumentesh*) ..., f. 232.

⁴³ Kristo Flloqi, “Gjyqësia në Shqipërië”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 3 shtator 1913, f. 3.

⁴⁴ “Propaganda e armiqve”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 21 Kallënduar 1914, f. 1.

⁴⁵ “Gëzimi”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 18 shkurt 1914, f. 1.

*Shqipërië*⁴⁶ - arsyetonte Kristo Flloqi, një nga penat më të pranishme në faqet e *Përlindjes*.

Trashëgimia institucionale osmane, veçanërisht në sistemin e drejtësisë, shihej si pengesa kryesore që Shqipëria të barazohej me Perëndimin. Mungesa e një rrjeti të organizuar unik shkollor në gjuhën amtare konceptohej gjithashtu si një tjetër pengesë për projektin homogjenizues të elitës shqiptare, e cila deri në ditët tona nacionalizmin shqiptar e ka konsideruar të pashkëputur nga misioni i evropianizimit të Shqipërisë. Në mbështetje të politikës së qeverisë së përkohshme, rëndësi i jepej shekullarizimit në qeverisje. Shqiptarët duhet të përfaqonin shtetin laik, si autoriteti suprem që lejonte pluralizmin fetar dhe krijonte kushte barazie për të gjitha komunitetet. *“Vetë në Shqipëtarë nuk dihet ç’është fea, nga e cila mund të rjedhin shumë ligësira - siç kërkohet armikët t’ë përdorin për veglë-po përkundra Shqipëtarë nderon të gjithë fetë duke nëmëruar vellezër gjithë bashkëkombëtarët...”*⁴⁷.

Në Evropën e fillimshekullit XX fjala “përparim” ishte kthyer në fjalën çelës, ndërsa aftësia për të përparuar konsiderohej si një nga kriteret e pranimit dhe të njohjes së shteteve të reja kombëtare prej Fuqive të Mëdha. *“Qeveria duhet të vrapojë në organizmin e Shqipërisë duke i dhënë ngjyrën dhe frymën Evropiane e jo Asiatike që të mundim të rimë në rugë të qytetërimit”*, u bënte thirrje shqiptarëve, intelektualit Mihal Grameno⁴⁸. Në cilësinë e kryetarit të Gjykatës Politike e Penale të Vlorës, Kristo Flloqi tërhiqte vëmendjen e lexuesit për sistemin e drejtësisë, duke evidentuar qartë domosdoshmërinë e ndarjes së pushteteve. Ja si shprehej ai: *“Një nga detyrat e Qeverisë ishte edhe të vënit mbi rugë çështjen e Drejtësisë, e cila është një nga ato të tri fuqia më të mëdha e të parat e një Shtati, sikundër janë dhe fuqia Nomvënësia dhe Përmarrënia (Legjislativ dhe Ekzekutiv)”*⁴⁹. Ndërsa Mihal Grameno ndalej tek sistemi arsimor: *“Shkollat dhe zakonet që trashëguam nga Turqia t’i çporim sa të mundim me qenë se ato n’a vërtetojnë që janë të dëmta dhe përveç humbjes as nonjë fitim s’munt të kemi! Shqipëria është një shtet Evropian andaj duhet të qytetërohet e të marë shkollën e Evropës, se tjetërsoj është e dënuar të humbasë shpejt ose më vonë ...*

⁴⁶ Kristo Flloqi, “Gjyqësia në Shqipërië”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 3 shtator 1913, f. 3.

⁴⁷ Mihal Grameno, “Cilët jemi”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 16 gusht 1913, f. 2.

⁴⁸ Mihal Grameno, “Organëzimi i Shqipërisë”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 27 gusht 1913, f. 2.

⁴⁹ Kristo Flloqi, “Gjyqësia në Shqipërië”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 16 gusht 1913, f. 3.

*Mos pandehni se Shqipëria do të bëhet një Turqi e vogël e do të shkojë nga e vjetra? Jo kurrë!*⁵⁰.

Në shkrime nuk hezitohet të cilësoheshin si orientale, të liga, “të rrezikshme sa nuku nëmërohen dot as që mund të shkruen”, të gjitha ato kategori shoqërore, trajta të organizimit shoqëror, nënkultura apo mendësi, brenda shoqërisë shqiptare të trashëguara nga osmanët, të cilat konsideroheshin nga elitat si të papranueshme për kohën moderne. Theksi vihej tek niveli i ulët i nëpunësve të shtetit, dembelizmi dhe korrupsioni.

*“Nëpunësit duhet të jenë njerës të mësuar, të ditur, të nderçmë, të drejtë dhe punëtorë. Përtimi dhe hatëri nuku do të shkojnë paskëtaj si dhe mita (rushfeti) se përveç të përzunit nga nëpunësia do të dënohet e burgoset... Vetëm atëherë, kur gjithë Shqipëtarët do të mbushën detyrën e tyre kush me tregti, kush me mjeshteri, kush me bujqësi, kush me industri dhe kush me nëpunësi, Shqipëria do të lulëzohet e qytetëroret për së shpejti e të nëmërohet vërtet një nga shtetet e qytetëruarë! Prandaj për lulëzimin të atdheut të vropojmë në punë e të largohemi sa të mundim nga trashëgimet e liga që n’ a mbetnë nga Turqia”*⁵¹.

IV. Shoqëria shqiptare në udhëkryq

Ndërsa qeveria e përkohshme e Vlorës shpallte vendime për zbatimin e modelit perëndimor në qeverisje dhe zëdhënësja e saj *Përlindja e Shqipëniës* përpiquej të “bënte shqiptarët”⁵², natyrshëm lind pyetja: A ishte e gatshme shoqëria shqiptare për ta pranuar atë?

Përgjigjja është e shkurtër dhe e prerë: Jo. Pavarësisht vullnetit të elementëve të spikatur të qeverisë së përkohshme të Vlorës, reforma shekullarizuese mbeti në letër dhe rezultoi e parakohshme. Arsytet thelbësore të këtij rezultati duhet ta kërkojmë tek prapambetja e shoqërisë shqiptare, mungesa e një jete të organizuar mbi institucionet kombëtare, mungesa e kultivimit të shqipes si një gjuhë e shkruar, pamjaftueshmëria e infrastrukturës materiale dhe njerëzore. Ishte e vështirë që menjëherë pas shpërndarjes nga Perandoria Osmane, shoqërisë shqiptare, duke

⁵⁰ Mihal Grameno, “Për nëpunësit”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 3 shtator 1913, f. 2.

⁵¹ Mihal Grameno, “Trashëgimet e liga që fituam nga Turqia”, në *Përlindja e Shqipëniës*, 23 gusht 1913, f. 2.

⁵² “*Shqipëria u bë, po duhen bërë Shqipëtarët!*”- kështu shprehej Kristo Floqi në shkrimin e tij “Gjyqësia në Shqipërië” botuar në *Përlindja e Shqipëniës*, 20 gusht 1913, f.3.

përfshirë këtu edhe një pjesë të elitës, t'i imponojë një sistem modern laik dhe evropian, të ndryshëm nga ai osman. Aq më tepër, kur një pjesë e qenësishme e saj kishte reaguar negativisht edhe ndaj reformave që vetë shteti osman kishte ndërmarrë para vitit 1912⁵³.

Qytetërimi osman në thelb mbështetej në doktrinën e Muhamedit, ndërsa ai evropian në atë të Krishtit, kryesisht morale, që ndante fenë nga qeverisja. Në dallim, doktrina e Muhametit nuk ishte vetëm morale e fetare, ishte gjithçka: politike, shoqërore, juridike etj., çka i kishte dhënë një natyrë teokratike dhe autoritare shtetit osman. Natyrshëm, dallimet midis botës myslimane dhe evropiane përfshinin edhe legjislatcionin, që rregullonte marrëdhëniet midis individëve, familjes, midis shtetit dhe individit. Përveç kësaj fetë dhe besimet krijojnë disa zakone, disa mendësi të posaçme, të cilat bëhen pengesë për grigjën e tyre, për të pranuar qytetërimet e tjera, të zhvilluara. Gjithë sa më sipër reflektohej edhe në shoqërinë shqiptare, si pjesë organike e asaj osmane. Ajo ishte dukshëm e shtresëzuar, tradicionale, e mbyllur, me tipare patriarkale e autoritare. Tradita dhe trashëgimia osmane e pranishme në botëkuptimin e shqiptarëve nuk mund të zhdukej vetëm me hartimin e kuadrit ligjor, sa hap e mbyll sytë. Sipas profesorit F. Braudel, përgjithësisht një shoqëri e ka tmerr të përqafojë një të mirë kulturore që vë në pikëpyetje strukturat e saj më të thella⁵⁴. “*Ne jemi otomanë*”, u kujtonte Esat pashë Toptani mbështetësve të tij në Shqipërinë e Mesme, në qershor të 1913-ës. *Sado që Shqipëria u nda, ju gjithë populli duhet të rini rehat si nënshtetas otomanë*⁵⁵ - përfundonte ai. Zhvillimet e mëtejshme historike dhe shoqërore në Shqipëri do të tregojnë se përshtatja e shqiptarëve me procesin e zëvendësimit apo ndryshimin e traditave, sistemit të kultit, organizimit ekleziastik dhe marrëdhënia që ata do të shfaqin në shtetin e tyre, do të rezultojë një proces i gjatë dhe i vështirë.

⁵³ Për reagimin që popullsia shqiptare i kishte bërë reformave të shtetit osman, duke nisur nga ato të Tanzimatit shih: N. Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar ...*, f. 121-128.

⁵⁴ F. Braudel, *Gramatikë e qytetërimeve...*, f. 64.

⁵⁵ *AIH*, A-IV-335. Materiale arkivore të grumbulluara nga Aleks Buda, Kristo Frashëri dhe Stefanaq Pollo, Vol II (maj 1913-shtator 1913), f. 83. Njoftim mbi një letër të Esat Toptanit dërguar mbështetësve të tij në Shqipërinë e Mesme, qershor 1913.

S u m m a r y“LET’S TAKE OUR EYES OFF TURKEY”! PERCEPTION ON THE OTTOMAN TURKS IN
THE DISCOURSE OF THE PROVISIONAL GOVERNMENT OF VLORA

Secession from the Ottoman Empire and the establishment of the Albanian independent state in 1912 placed institutions and their organization within a new political, legal and administrative reality, other than the one they had already operated in thus far. Although under provisional legitimacy, the government of Vlora was focused on fundamental issues of governance, in which prevailed building of centralized secular/non-religious systems, typically a characteristic feature of western governments. Such an attempt can be considered as the beginning of a long state formation and deottomanization process across which Albanians and their state would go through.

In the external discourse of the government of Ismail Kemal Vlora the perception about ottoman Turks holds diplomatic and institutional connotations, which is a distinctive characteristic even in the earlier speech of its president. Although with somewhat dim tones, constituent part of the external discourse of the provisional government of Vlora are also the state secularization, religious pluralism, equality of religious communities before the law and state, as characteristics that would grant a European spirit to the newborn state, thus bringing it closer to the West and away from the East.

In internal discourse of the provisional government of Vlora assumes the civilizing mission to the society, whose perception and way of life did not fit in the elite’s vision, namely the government, about the state and society. Although a significant part of Albanian intellectuals of that time constituted a part of the ottoman context of state reformation, they strove to separate from the past, by differentiating Albanians from ottoman Turks insofar as possible, even though their majority belonged to the same religion, namely the Muslim one. The ottoman institutional legacy, especially in the justice system, is viewed as the main barrier to channel Albania on the Western line.

While the provisional government of Vlora proclaimed decisions regarding the implementation of the western model of governance and, its representative *Përlindja e Shqipëniës* was trying “to make Albanians”, naturally the question arises: *Was the Albanian society prepared to accept it?* The Albanian society as an organic part of the ottoman one was evidently stratified, traditional, closed, authoritarian and patriarchal. The ottoman tradition and heritage already present in Albanians’ outlook could not disappear only by drafting in a flash,

the legal framework. Subsequent historical and social developments in Albania will show that Albanians' adaptation to the process of replacing or changing traditions, worshipping system, ecclesiastical organization and their relationship with their state, would prove to be a long-lasting and difficult process.